



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Propozimet
e
Ministrisë së Shtetit
për
Mbrojtjen e Sipërmarrjes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Tipologjia e raportit Publik-Privat qëndron në thelb të debatit mbi zhvillimin ekonomik. Asnjë vend nuk ka mundur të shënojë rritje ekonomike, pa një shtet të fortë i cili të partnerizojë me sipërmarrësin duke ofuruar të mira publike kyçe si siguria e pronës, zbatueshmëria e ligjit apo përshtatja dhe përmirësimi i infrastrukturës. Shqipëria tashmë ndodhet në një moment themelor për të ardhmen e saj ekonomike. Angazhimet e ndërmarra në kuadrin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, ndjekur nga aksioni kundër informalitetit, si dhe reforma e deregulimit shoqëruar me lehtësimin e procedurave dhe burokracive në administratën publike, janë tregues i qartë i vullnetit të kësaj Qeverie për ta shndërruar Shqipërinë në portë hyrëse në tregëtinë rajonale.

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në këto javë të para të punës saj përpos trajtimit së çdo problematike që biznesi ka prezantuar në lidhje me ngërçe institucionale, i është dedikuar dhe njohjes së klimës së biznesit në Shqipëri, nëpërmjet takimeve individuale, këshillimeve me sipërmarrës dhe ekspertë, si dhe pjesëmarrjes në konferenca e organizimit të tryezave teknike.

Biznesi dhe tërë grupet e interes bashkërenduese me këtë sferë, janë të mirëorganizuar dhe një pjesë e madhe syresh nuk kanë hezitur të ofrojnë ekspertizën më të mirë nëpërmjet raporteve të prodhuar prej tyre.

Ndaj propozimet e shtruara në vijim vijjnë si rrjedhojë e një sinergjie shumë palëshe, rezultat i një ndër objektivate kryesore në themel të krijimit të kësaj ministrie, ai i nxitjes së transparencës dhe përmirësimit të komunikimit. Theksojmë se ky guideline propozues nuk do të jetë i vetmi, ai është thjesht i pari nga një sërë pasuesish që do të prodhohen në mënyrë periodike dhe që do të botohen në faqen tonë zyrtare www.sipermarrja.gov.al

Zyra jonë është e hapur në cdo kohë për cdo sipërmarrës të huaj apo vendas që has në pengesa të pajustificueshme, nëpërmjet kontaktit në faqen tonë zyrtare, adresës elektronike info@sipermarrja.gov.al dhe portalit e-albania.

Së fundmi gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë komunitetin e biznesit në Shqipëri, për kontributin dhe mbështetjen e ofruar. Bashkëlidhur do të gjeni propozimet tona në mënyrë të argumentuar.

PASQYRË LËNDE

1. KLIMË BIZNESI

Sekretariati Teknik i KEK



2. BUJQËSI

Hartimi dhe zbatimi i platformës elektronike në bujqësi dhe agrobiznes

3. DOGANA

Zbatimi i Çmimit të Referencës

4. TATIME

Rishqyrtimi i Udhëzimit nr.6 "Për Tatimin mbi Vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 19, pika 4.

Krijimi dhe Zhvillimi i E-Tatime

Propozim për zbatim të drejtë të pikës 7 të nenit 44 të Ligjit për procedurat tatimore

Kategorizim si shkelje administrative të akteve të përpiluara nga administrata fiskale të pambështetura specifikisht në kuadrin ligjor

Propozim për moslogaritjen e kamatvonesave për detyrimet tatimore për të ardhura të parealizuara si rezultat i vonesave të likuidimeve për furnizime të entit shtetëror, si dhe parashikimi i mosfillimit të procedurave që nga njoftimi i pagesës deri te masat për vjeljen me forcë të detyrimeve

5. LEJE DHE LIÇENCA

Ngritja e Urdhërit të Inxhinierëve

Përmbledhje Deklarative

KLIMË BIZNESI

Sekretariati Teknik i KEK në varësi të MMS

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka ndërmarrë nismën për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 57/2014 për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar, ku propozohet që KEK nga MFE të kalojë në përgjegjësinë e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Argumentim

Krijimi i Sekretariatit Teknik me detyra të mirëpërcaktuara për të përmbushur detyrimet që lindin nga ligji 57/2014 si dhe funksionimi i këtij sekretariati teknik në varësi të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes si garantues për përmbushjen e detyrimeve të fushës së përgjegjësisë shtetërore të kësaj ministrie në funksion të garantimit të një partneriteti sinergjik publik-privat.

Propozim

Pas miratimit të ndryshimeve ligjore do të propozohet miratimi i një VKM për krijimin dhe funksionim e Sekretariatit Teknik në varësi të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

BUJQËSI

Hartimi dhe zbatimi i platformës elektronike në bujqësi dhe agrobiznes

Në Shqipëri në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agrobiznesit operojnë mb 350 mijë ferma. Aktualisht rreth 10% e tyre janë të pajisura me NIPT, dhe kanë mundësi për të krijuar marrëdhënie formale me tregun, për marrëdhënie me AZHBR për të përfituar mbështetje nga politikat lehtësuese të qeverisë, si dhe me institucionet tatimore dhe kështu mund të konsiderohen të formalizuara. Pjesa e mbetur prej 90%, porë në këtë kontekst aktualisht konsiderohet e pa formalizuar. Megjithatë ka një kërkesë të ligjit për tu regjistruar, Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor nuk mund të regjistrohen mbasi programi QKB nuk ka të parashikuar asnjë opsion për regjistrimin e tyre.

Argumentim

Kjo platformë do t'i shërbejë Qeverisë për formalizimin e shpejt dhe përfundimtar të fermerëve, fermave, subjekteve të agrobiznesit në zonat rurale. Do të shërbejë në veçanti për një përmirësim rrënjësor të procesit të gjurmueshmërisë në fushën e zhvillimit të bujqësisë sociale dhe agrobiznesit. Gjithashtu do t'i shërbejë sektorit privat dhe qeverisë për të përmirësuar e mbështetur politikat lehtësuese të financimit, të kooperimit dhe ato fiskale, për zhvillimin e bujqësisë sociale dhe agrobiznesit. Institucionit të tatimeve do t'i mundësojë e lehtësojë shumë zbatimin e politikave për shtrirjen në shkallë të gjërë të TVSH.

Përveç formalizimit dhe detyrave të tjera specifike që mund të realizojë Qendra Kombëtare e Agrobiznesit, do t'u krijojë institucioneve publike si zyra të statistikës, të tatimeve dhe doganave, AZHBR, një vizion të ri, për të përmirësuar ndjeshëm eficientësinë e veprimtarisë së tyre në dobi të mbështetjes me transparencë të fermerëve, fermave, SHBB, Federatave të SHBB dhe subjekteve të agrobiznesit të angazhuara për zhvillimin e bujqësisë sociale dhe agrobiznesit në Shqipëri.

Propozim

Hartimi dhe krijimi i platformës elektronike për zhvillimin e bujqësisë sociale dhe agrobiznesit në Shqipëri, e cila do të mbështetet në tre shtyllat e mëposhte:

- (i) Karta Elektronike e Fermerit
- (ii) Regjistri Elektronik i Fermës dhe Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- (iii) Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Agrobiznesit

Ristrukturimi i objektivave të projektit ekzistues në MBZHR për përshpejtimin e procedurave të përfundimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Fermës.

Amendimi i ligjit 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor", përgatitja dhe miratimi i një vendimi qeverie për regjistrimin e fermerëve, fermave, SHBB dhe Federatave të tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Agrobiznesit.

DOGANA

Zbatimi i çmimit të referencës

Subjektet kanë depozituar ankesa për aplikimin e çmimeve të referencës edhe kur faturat, transaksioni, deklarata e eksportit etj. i përmbushin kriteret për tu trajtuar me vlerën e transaksionit. Ky fenomen nga ana e administratës doganore krijon problematika tek subjektet për pagesën e detyrimeve doganore. Aplikimi i referencave në mënyrë selektive nxit edhe konkurrencën e pandershme.

Argumentim

Nga këndvështrimi fiskal marrja e TVSH-së në bazë të aplikimit të referencës si mënyrë vlerësimi për vlerën e mallit vetëm rrit pakënaqësinë e sipërmarrjeve pasi vlera reale e TVSh-së që hyn në buxhetin e shtetit përcaktohet nga çmimi i shitjes. Rritja e vlerës në import në disa raste çon dhe në shmangie të deklarimit të fitimit real dhe në shmangien e vjeljes së tatimit dhe dividendit.

Propozim

Propozojmë që subjektet që përmbushin kushtet për aplikimin e vlerës së transaksionit të mos trajtohen me vlerë reference, por të mbizotërojnë mënyrën e vlerësimit me vlerën e transaksionit.

TATIME

Rishqyrtimi i Udhëzimit nr.6

“Për Tatimin mbi Vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 19, pika 4

Në propozimet e dorëzuara nga BTSH raportohet problematikë në lidhje me metodën e marrjes së TVSH nga furnizuesi kryesor.

Argumentim

Udhëzimi i mësipërm, Neni 19, paragrafi 4.2, nënparagrafi (ii) përmban një dispozitë që detyron furnizuesin kryesor (importuesin) që në rast rritjeje të çmimit me pakicë të deklarojë dhe të paguajë TVSH për pjesën e rritur të çmimit për cigarette gjendje në të gjitha hallkat e tregut. Kjo kërkesë është pazbatueshme nga importuesi pasi ai nuk mund të ketë autoritetin ligjor dhe informacionet për të evidentuar cigaret gjendje te çdo tregtar. Importuesi paguan TVSH me çmimin final me pakicë në momentin e furnizimit prej tij, pra për sasinë e mallit që ai furnizon dhe faturon.

Propozim

“(ii) Në momentin e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë, furnizuesi kryesor aplikon në çmimin e rid he oaguan TVSH të llogaritur bazuar në këtë çmim të ri për çdo sasi malli të shitur prej tij nga ai moment e në vijim. Çdo tatimpagues tjetër, i regjistruar si tatimpagues TVSH-je, përfshirë distributorët, shitësat me shumicë e pakicë janë të detyruar të dorëzojnë/ngarkojnë elektronikisht në sistemin tatimor, brenda dy ditëve të punës nga data e hurjes në fuqi të çmimit të ri, një deklaratë të inventarit fizik të cigareve të pashitura, për të cilat do të aplikohet çmimi i rritur. Bazuar në deklaratën e gjendjes së inventarit, tatimpaguesi duhet të lëshojë një faturë tatimore me TVSH, ku tatimpaguesi figuron si shitës dhe si blerës në mënyrë që të paguajë TVSH për sasinë e cigareve gjendje që do të shiten me çmimin e rritur. Kjo faturë deklarohet vetëm në librin e shitjes së TVSH si shitje e tatueshme, vetëm për efekt pagese të TVSH-së për rritjen e vlerës të stokut për shkak të rritjes së çmimit.

*Propozim për mosllogaritjen e kamatvonesave për detyrimet tatimore
për të ardhura të parealizuara si rezultat i vonesave të likuidimeve
për furnizime të entit shtetëror*

Në vazhden e trajtimit të ankesave jemi njohur me një fenomen fiskal që frenon dukshëm interesin e sipërmarrjeve për pjesmarrje në ndërtimin e veprave publike.

Argumentim

Operatorët kontraktues janë të detyruar në bazë të legjislacionit në fuqi të deklarojnë dhe paguajnë për aktivitetin e tyre në mënyrë të përmuajshme për TVSH dhe Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe të paguajnë tatim fitimin paraprak i cili ngarkohet me gjobë për mospagesë.

Këta operatorë përballen me vështirësi ekonomike për të kryer furnizimin sipas kontratës, si dhe për të paguar detyrimet tatimore të cilat në rastin e mospagimit në afat përveçse ngarkohen me interesa edhe procedohen si detyrim tatimor duke ju nënshtruar masave të vjeljes me forcë të këtij detyrimi në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008.

Propozim

MMS në kuadër të autoritetit si avokat mbrojtës i biznesit, duke u mbështetur në argumentin që detyrimi tatimor lind nga një e ardhur e realizuar, në kuptim të nenit 6 të procedurave tatimore që përcakton rrethanat e lindjes së një detyrimi tatimor, pika 1 e këtij neni, propozon që pika 4 e nenit 76 Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008, të parashikojë heqjen e kamatëvonesave për të ardhurat e pa realizuara, për pagesa të pakryera nga thesari i shtetit.

Gjithashtu në nenin 29 të parashikohet si kategori e detyrimit tatimor realizimi i të ardhurës. Ky kategorizim të bëhej në rastet e pagesave të pakryera nga thesari me qëllim shmangien e fillimit të procedurave që nga njoftimi për pagesë deri në fillimin e masave të vjeljes me forcë të detyrimit.

Krijimi dhe zhvillimi i E-Tatime

Megjithëse Shqipëria renditet në nivele mesatare në lidhje me “kohën e harxhuar për deklaratimet tatimore”, bizneset lokale paraqesin një tablo të larmishme në lidhje me këto çështje, sidomos kur pyeten për procedurat tatimore. ILO në bashkëpunim me BIZNESALBANIA pas anketimeve të kryera në mbi 500 biznese vlerëson se orë të tëra pune humbiten në zyrat e Drejtorisë së Tatimeve.

Argumentim

Thjeshtimi i procedurave tatimore, kryerja e më shumë shërbimeve online duke përfshirë ato informueset, si edhe përqëndrimi në pagesat online të tatimeve mund të sjellë reduktim të kohës së harxhuar për çështjet tatimore si dhe mundësitë për përfshirjen e administratës publike në akte korruptive.

Propozim

Ngritja dhe zhvillimi i një platforme online që të mundësojë kryerjen e më shumë shërbimeve tatimore online, si pagesat e tatimeve, rimbursimi i tatimeve, përputhja e faturave të TVSH-së dhe e faturave doganore.

Kategorizim si shkelje administrative të akteve të përpiluara nga administrata fiskale të pa mbështetura specifikisht në kuadrin ligjor

Në ankesat e sipërmarrjes të dokumentuara pranë zyrës së Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, evidentohen masa të ndërmarra nga administrate fiskale të pambështetura specifikisht në kuadrin ligjor si p.sh: Penalizimi për përshkrim të pa saktë të artikullit në kuponin tatimor, që bie ndesh me kundërvajtjet e parashikuara në nenin 122 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008. Kjo masë nuk parashikohet në nen.

Argumentim

Përpilimi i akteve administrative të pambështetura specifikisht në kuadrin ligjor të cilat bartin pasoja për sipërmarrjen duhet të jetë subjekt i konstatimit të shkeljes administrative nga punonjësi i administratës fiskale.

Propozimi

Propozohet parashikimi në kuadrin ligjor i kundravajtjeve administrative edhe për administratën fiskale. Në vijim do të propozohet ngritja e një grupi pune që do të merret me vlerësimin empirik të detyrimit të ngarkuar në sistem të pagesave dhe të numrit të njoftim vlerësimeve të dala me këtë konstatim.

Propozim për zbatim të drejtë të pikës 7 të nenit 44 të Ligjit për procedurat tatimore

Në ankesat e depozituara pranë Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, BTSH ka paraqitur si problematike situatën e vendosjes së penaliteteve për subjektet shitëse ndaj një personi pasiv. Këto penalitete janë vendosur në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin pasi në ligj parashikohet shkelje administrative, kryerja e transaksionit vetëm nga subjekti pasiv ndërsa në Udhëzim parashikohet shkelje administrative edhe për subjektin blerës ndaj një personi pasiv. Evidentojmë që nuk është problematikë e vetme vendosja e penaliteteve në kundërshtim me nenet specifike të legjislacionit në fuqi por kemi tejkallim të parashikimeve në udhëzim kundrejt përcaktimeve ligjore.

Argumentim

Kjo pikë e parashikuar në ligj, mbart përgjegjësi vetëm për personin i cili është në listën e pasivëve dhe vërtetohet që ka kryer transaksion, ndërkohë që në UDHËZIM Nr. 7, datë 10.1.2017 PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR parashikohet shkelje administrative edhe për palën blerëse nga një subject pasiv. Jemi në kushtet që udhëzimi është në tejkallim të ligjit.

Propozim

Propozohet nga MMS heqja e paragrafit nga Udhëzimi nr.7 datë 10.01.2017

"Gjithashtu për çdo transaksion të kryer nga një tatimpagues blerës me një tatimpagues shitës që është në regjistrin pasiv, i publikuar në faqen zyrtare të tatimeve në listën e tatimpaguesve pasiv, konsiderohet shkelje si për shitësin dhe për blerësin dhe ky i fundit është përgjegjës bashkë me furnizuesin (shitësin) për pagesën e TVSH-së. Tatimpaguesi i cili aktivizohet duke hequr dorë nga pezullimi i veprimtarisë, në momentin që bëhet aktiv, administrata e heq nga lista e tatimpaguesve pasiv".

Gjithashtu afati 10 ditor që l është lënë në dispozicion administratës për njoftimin e tatimpaguesit që ka kaluar në listën e pasivëve lë hapësirë kohore për konsumimin e shkeljes administrative.

LEJE DHE LIÇENCA

Ngritja e Urdhërit të Inxhinierëve

Në vijim të problematikës së raportuar nga Shoqata e Inxhinierëve Shqiptar, të cilët në bazë të rregullave të prokurimit publik, pjesa që i takon shërbimit të konsulencës, hasnin problem me sistemin e vlerësimit të ofertave lidhur me kërkesat skualifikuese për referencat e shërbimeve të kryera në tre vitet e fundit, gjithashtu në lidhje me kërkesat e shprehura në VKM 914, datë 29.12.2014, neni 28 kontratat e shërbimeve, që përkakton kërkesa specifike të cilat elimonojnë në mënyrë të padrejtë operatorët ekonomik që nuk kanë mundur të kenë referenca për punime të ngjashme në tre vitet e fundit.

Argumentim

Nga problematika e ngritur u vërejt se kriteret për vlerësimin e konsulencës më të mirë nuk ishin kritere të përshtatshme dhe të vlerësuara nga persona autoritativë të sektorit.

Propozim

Ngritje e Urdhërit të Inxhinierëve, i cili do të marri rolin e një autoriteti për monitorimin e standardeve të projekteve dhe konsulentëve inxhinierike.

Përmbledhje Deklarative

Reforma e deregulimit është një iniciative e Kryeministrit me në qendër qytetarin dhe sipërmarrjen si përfitues të drejtëpërdrejtë të shërbimeve publike. Kjo reformë shënjon përpjekjen e Qeverisë për ta kthyer shtetin në shërbim të qytetarit dhe sipërmarrjes.

Kjo reformë ka për qëllim lehtësimin e hapave dhe procedurave që duhet të ndiqen për përfundimin e një shërbimi.

Një ndër problemet kryesore është sasia e lejeve, licensave dhe autorizimeve që sjell vështirësinë e inventarizimit të tyre dhe moskoordinimin e institucioneve të lidhura. Ndaj, reduktimi i numrit aktual të lejeve, licensave dhe autorizimeve është aspekti i parë i reformës së deregulimit.

Procesi i derregullimit do të kalojë në një fazë të re konsultimi me grupet e interesit, gjatë të cilave do të punohet për hartimin e një liste fundore të lejeve, autorizimeve dhe licensave të lehtësuara, e cila do jetë pjesë e Ligjit për Lejet, Licencat dhe Autorizimet në Republikën e Shqipërisë. Më poshtë paraqitet vlerësimi i lehtësimit ndërsektorial.

MINISTRIA	Eliminim Dok.	Dok. me Integrim	Total lehtësim	Total % lehtësimi
MASR	168		168	66%
MB	11	46	57	8%
MBZHR	68		68	63%
MD	46	4	50	12%
MFE	100	151	251	11%
MIE	354	52	406	23%
MK	119	16	135	54%
MK	54	30	84	16%
MSHMS	118	3	121	40%
MTM	23	20	43	35%